



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 14 dt. 18.04.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.04.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e z. Veli Shehu, për t’u shkëputur si drejtues teknik nga shoqëria “KARL GEGA KONSTRUKSION” dhe bazuar në nenin 22, pika 3 të rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”,

VENDOSI:

1. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, heqjen e licensës në fushën e restaurimit R.SH. 22, për shoqërinë “KARL GEGA KONSTRUKSION” sh.p.k, me drejtues ligjor Z. Hartjan Sallaku.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO-FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI